



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.79/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/156-2026, të datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë **03.02.2026**, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.79/2025, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/156-2026 i datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.79/2026, nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së të datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, lidhur parregullsitë në marrjen e votave nga Koalicioni Vakati në vendet e votimit ku nuk ka anëtarë të komunitetit boshnjak, duke shkelur kështu Kushtetutën e Republikës së Kosovës për vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës.

Parashtruesja e ankesës në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të subjektit politik Nova Demokratska Stranka, dhe në përputhje me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregulloren nr. 01/2025 për Procedurat për Parashtrimin dhe Vendosjen për Ankesat, ka parashtruar këtë ankesë me te cilën pretendon rreth parregullsive të konstatuara në pranimin dhe evidentimin e votave për subjektin politik Koalicioni Vakati, i cili

konkurroi për vendin e rezervuar të komunitetit boshnjak, ku ata morën vota në vendet e votimit ku nuk ka prani të anëtarëve të komunitetit boshnjak.

Sipas parashtrueses së ankesës në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor, Koalicioni Vakrat, sipas të dhënave qendrore zgjedhore, në vendin e votimit nr. 2034 - Velezhë, komunë e Prizrenit, mori 85 vota brenda llogaritjes për vendin e rezervuar deputet të komunitetit boshnjak. Fshati Velezhë vendi i votimit nr. 2034 në komunën e Prizrenit është pothuajse tërësisht i populluar me popullsi shqiptare, pa anëtarë të komunitetit boshnjak, pa familje boshnjake. Përkundër këtij fakti të padiskutueshëm, votat e përmendura janë përfshirë në shpërndarjen e mandatit të rezervuar boshnjak, duke shkelur kështu kornizën kushtetuese dhe ligjore. Parashtruesja e ankesës thekson se Ekziston tashmë një praktikë gjyqësore e qartë dhe e konsoliduar. Në Vendimin Abr.656 / 2021, datë 07.03.2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, theksohet se: Aspirata për krijimin të praktikave të tilla të votimit masiv të anëtarëve të një komuniteti për subjektet e një komuniteti tjetër, është një praktikë e rrezikshme të cilën në të ardhmen mund ta përdorë komuniteti shumicë, duke ia mohuar atij të drejtën e përfaqësimit objektiv të komunitetit të pakicës. E njëjta thekson se anulimi i pjesshëm i votave për subjektet e përmendura në dispozitën e këtij vendimi ka për qëllim ruajtjen dhe garantimin e të drejtës së përfaqësimit, në raport me përqindjen e popullsisë nga ky komunitet të garantuar me ligj dhe Kushtetutë. Për të përcaktuar plotësisht dhe saktë gjendjen faktike, propozohet nxjerrja e dëshmi të mëposhtme: Regjistrimi i Popullsisë 2024 – si dhe të dhënat zyrtare të publikuara të vitit 2025 nga organi kompetent shtetëror për statistikë, nga ku del se fshati Velezhë, komuna e Prizrenit, është i populluar me popullsi shqiptare, pa familje të evidentuara të komunitetit boshnjak; Raporti demografik sipas vendbanimeve (raport i vitit 2025), i cili konfirmon numrin e banorëve, strukturën etnike, mos ekzistencën e familjeve boshnjake në fshatin Velezhë; Lista zyrtare e votuesve për vendin e votimit Velezhë, nga e cila del se nuk ekzistojnë votues të regjistruar që deklarojnë se janë anëtarë të komunitetit boshnjak; Rezultatet qendrore të zgjedhjeve të KQZ-së për vendin e votimit Velezhë, si dëshmi për përllogaritjen e 85 votave për Koalicionin Vakrat, Vendimi Abr.656 / 2021 i PZAP-së

Andaj e njëjta thekson se dëshmitë e përmendura janë relevante, të ligjshme dhe vendimtare për zgjidhjen e saktë të kësaj anese, dhe propozon që PZAP-ja, të anulojë 85 votat e ndara Koalicionit Vakrat në vendin e votimit nr. 2034 Velezhë, komunë e Prizrenit, në llogaritjen për vendin e rezervuar deputet të komunitetit boshnjak; të urdhërohet Komisioni Qendror Zgjedhor që të rishqyrtojë rezultatin zgjedhor dhe të përjashtojë (fshijë) nga rezultatet përfundimtare 85 votat që Koalicija Vakrat i ka marrë në vendin e votimit 2034 Velezhë në komunën e Prizrenit, të zbatojë të njëjtin standard ligjor si në rastet e mëparshme, duke përfshirë rastin Adriana Hoxhiq - Vendimi Abr.656 / 2021 i datës: 07.03.2021 i PZAP-së.

Më tutje në ankesë thekson se përdorimi i votave nga një mjedis i cili, sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë 2024, është i komunitetit shqiptar, për shpërndarjen e mandatit të rezervuar boshnjak përfaqëson një shkelje të qartë dhe të provueshme të rendit kushtetues dhe ligjor, dhe PZAP-ja është e detyruar të mbrojë integritetin e sistemit të mandateve të rezervuara dhe të sigurojë zbatimin konsekuent të të drejtës.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja lidhur me pretendimet e palës ankuese ka theksuar se sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës e ndërton të drejtën e votës mbi dy parime që ekzistojnë njëkohësisht dhe në mënyrë të pandashme. Së pari, barazinë e votës dhe fshehtësinë e saj. Neni 45 i Kushtetutës garanton të drejtën e çdo qytetari për të votuar pa kushtëzim identitar, ndërsa fshehtësia e votës përjashton çdo mekanizëm shtetëror që do të mund të

verifikonte se kush ka votuar për kë dhe për çfarë arsye. Edhe në kontekstin e vendeve të garantuara për komunitetet jo-shumicë, Kushtetuta dhe legjislacioni zgjedhor nuk krijojnë zona zgjedhore etnike dhe nuk autorizojnë administratën zgjedhore të verifikojë identitetin etnik të votuesit, Mekanizmi i vendeve të garantuara është një instrument për sigurimin e përfaqësimit institucional, por ai nuk e shndërron votën në akt të kushtëzuar etnikisht dhe as nuk e lejon shtetin të bëjë kontroll etnik të votuesve.

Lista e Votuesve nuk përmban të dhëna mbi përkatësinë etnike dhe KQZ nuk posedon, as teknikisht dhe as juridikisht, instrumente për të identifikuar përbërjen etnike të votuesve. Çdo kërkesë për anulim votash mbi bazë të interpretimeve demografike nënkupton krijimin e një mekanizmi të kontrollit etnik të votimit, i cili nuk ekziston në rendin juridik të Kosovës dhe do të ishte në kundërshtim me parimin e fshehtësisë së votës. Në këtë kontekst, referencat e palës ankuese në praktikën gjyqësore të mëhershme nuk e zgjerojnë mandatin e KQZ-së dhe vlerësimet e bëra nga PZAP dhe Gjykata Supreme në raste të caktuara përfaqësojnë ushtrim të kompetencës gjyqësore mbi bazë të provave të paraqitura në ato procedura.

KQZ, si organ administrativ, nuk mund të riprodhojë ex officio analiza gjyqësore mbi identitetin apo qëllimin e votuesve dhe as të krijojë mekanizma të rinj hetimorë që nuk parashihen në legjislacionin zgjedhor. Specifikisht, Gjykata Kushtetuese, në aktgjykimin KI69/21, ka theksuar se garancia e zgjedhjeve të lira përjashton çdo kërkesë që kandidatët apo votuesit të deklarojnë përkatësinë etnike dhe se pjesëmarrja efektive e komuniteteve sigurohet përmes dizajnit institucional të sistemit zgjedhor, jo përmes kontrollit individual të votës. Ky standard vendos kufi të qartë ndaj çdo modeli të anulimit selektiv të votave mbi bazë të supozimeve për identitetin e votuesve. Prandaj, përfundimisht, pretendimet e palës ankuese nuk identifikojnë shkelje procedurale në administrimin e procesit zgjedhor. Nuk pretendohet manipulim i materialit zgjedhor, cenim i zinxhirit të sigurisë, ndërhyrje në kuti votimi apo shkelje në procesin e numërimit. Ankesa mbështetet në interpretime statistikore dhe demografike të rezultateve. Statistika nuk përbën provë juridike të parregullsisë zgjedhore dhe nuk mund të zëvendësojë standardin e provës për anulim votash, Kërkesa e palës ankuese për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve, nuk qëndron, për shkak se ajo duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, e as nuk mund të shpallet fletëvotimi i pavlefshëm në bazë të përkatësisë etnike të votuesit, Rastet e shpalljes së fletëvotimit të pavlefshëm parashihen në paragrafin 2.2 të nenit 16 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi Në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit. Gjithashtu, në procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me datë 04.12.2025, nr. 01/3631/2025 për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, janë paraparë shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme. Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit, Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit parashihet në nenin 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 10/2024 për Fletëvotimet dhe Broshurat. Në këto rrethana, pretendimet e paraqitura nuk demonstrojnë shkelje të procesit zgjedhor dhe nuk mbështeten në bazë juridike për anulim votash, Rezultati zgjedhor mbetet shprehje e votës së lirë dhe të fshehtë të qytetarëve dhe si i tillë gëzon mbrojtje kushtetuese,

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtrueses së ankesës e cila pretendon se në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025 Koalicioni Vakati, sipas të dhënave qendrore zgjedhore, në vendin e votimit nr. 2034 - Velezhë, komunë e Prizrenit, mori 85 vota brenda llogaritjes për vendin e rezervuar për deputet të komunitetit boshnjak, nga ku fshati Velezhë në komunën e Prizrenit është pothuajse tërësisht i populluar me popullsi shqiptare, pa anëtarë të komunitetit boshnjak, pa familje boshnjake, sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LKP-së, që parasheh se “*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: “*Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor*. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: “*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*.” Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin KI69/2021, ndër të tjera ka sqaruar se: Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të 85 fletëvotimeve në vendvotimet nr.2034 në Velezhë, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovë.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetojë se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZPAnr.79/2026 më datën 03.02.2026

Kryesues i Panelit

Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.8/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nenad Lazic, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së Emilija Rexhepit, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datën 28 Dhjetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.79/2026, të datës 03.02.2026, në seancën e mbajtur më datë 09.02.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.Anr.79/2026, të datës 03.02.2026, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZP.Anr.79/2026, të datës 03.02.2026, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.Anr. 79/2025, e datës 02.02.2026, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/156-2026 i datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë ankesën, si të bazuar, të ndryshohet vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), nr. ZP.Anr.79/2026, të datës 03.02.2026, ashtu që të anulohen 85 votat e numëruara për subjektin politik "Koalicija Vakati" në vendvotimin nr. 2034 - Velezhë, Komuna e Prizrenit, në kuadër të llogaritjes për mandatin e rezervuar për komunitetin boshnjak, të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të korrigjojë rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve dhe të përjashtojë nga llogaritja për mandatin e rezervuar boshnjak 85 votat e dhëna për "Koalicija Vakati" në qendrën e votimit nr. 2034-Velezhë.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.79/2026, i datës 03.02.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 02.02.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.79/2026, nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së të datës 31.01.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, lidhur parregullsitë në marrjen e votave nga Koalicioni Vakati në vendet e votimit ku nuk ka anëtarë të komunitetit boshnjak, duke kërkuar më saktësisht si në ankesë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS).

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZP.Anr.79/2026, të datës 03.02.2026, me të cilën e ka refuzuar ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Pretendimet e parashtrueses së ankesës e cila pretendon se në zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025 Koalicioni Vakati, sipas të dhënave qendrore zgjedhore, në vendin e votimit nr. 2034 - Velezhë, komunë e Prizrenit, mori 85 vota brenda llogaritjes për vendin e rezervuar për deputet të komunitetit boshnjak, nga ku fshati Velezhë në komunën e Prizrenit është pothuajse tërësisht i populluar me popullsi shqiptare, pa anëtarë të komunitetit boshnjak, pa familje boshnjake, sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë të pabazuara duke iu referuar nenit 6 paragrafi 2 i LZP-së, që parasheh se "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë", duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve.



përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Ka shtuar se po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: "Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: "Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë." Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin K169/2021, ndër të tjera ka sqaruar se: Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të 85 fletëvotimeve në vendvotimet nr.2034 në Velezhë, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t'u zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar, pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetojë se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga subjektit politik Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), lidhur parregullsitë në marrjen e votave nga Koalicioni Vakut në vendet e votimit ku nuk ka anëtarë të komunitetit boshnjak, përkatësisht 85 votat e dhëna për “Koalicija Vakut” në qendrën e votimit nr. 2034-Velezhë.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranojë si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e PZAP-së edhe për zbatim të së drejtës materiale për arsye se:

Me nenin 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcaktohet se: “1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. E drejta e votës mund të kufizohet me vendim gjyqësor.”.

Me nenin 117 paragrafi 1, 3 dhe 4 të këtij ligji përcaktohet se: “1. PZAP-ja miraton akt të veçantë për procedurat e parashtrimit dhe vendosjes së ankesave nga palët e autorizuar, siç përcaktohet me dispozitat e këtij ligji. 3. Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse. 4. PZAP-ja mund të urdhërojë rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën e parashtruar”.

Me nenin 120 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij ligji përcaktohet se: “1. Në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të: 1.1. urdhërojë një subjekt politik ose një organizatë vëzhguese të ndërmarrë masa përmirësuese; 1.2. para certifikimit të rezultateve zgjedhore, është në kompetencë të PZAP-së, në raste të jashtëzakonshme të anulojë rezultatet në një vendvotim apo qendër votimi, dhe ta urdhërojë KQZ të përsërisë votimin në një qendër votimi apo vendvotim, nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale; dhe 1.3. të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.

Me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përcaktohet se: 1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë ikufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.

Me nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcaktohet se: “1. Fletëvotimi konsiderohet i vlefshëm nëse: 1.1. Është i vulosur; 1.2. ka numrin serik të VV përkatës. 2. Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik; 2.2. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik; 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik; 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; 2.2.4.



kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave dhe nga dispozita e lartcekur, erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar, ndërsa vendimi i PZAP-së është i drejtë dhe i ligjshëm. Në rastin konkret bazuar në dispozitën ligjore nga neni 6 paragrafi 1, 2 dhe 3, 117 dhe 120 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, rezultoi fakti se kërkesa që të anulohen 85 votat e dhëna për "Koalicija Vakati" në qendrën e votimit nr. 2034-Velezhë, është e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se PZAP, drejt ka vendosur lidhur me ankesën e ankuesit dhe në mënyrë të drejtë i është referuar aktgjykimit në rastin K169/2021 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, për faktin se përveç pjesës të cilës i është referuar PZAP, Gjykata Kushtetuese në mënyrë të qartë ka sqaruar faktin se, kriteret mbi bazën e të cilave votat mund të shpallen të pavlefshme, janë të përcaktuara në rregullativën e KQZ-së, dhe me dispozitat ligjore të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe se këto rregulla duhet të zbatohen në mënyrë strikte lidhur me anulimin e votave të kontestuar.

Përveç të cekurave Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka sqaruar faktin se, në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore; dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se bazuar në dispozita ligjore dhe rregullat zgjedhore të lartcekura të cilat përcaktojnë qartë mënyrën se kur konsiderohet një fletëvotim i pavlefshëm, rezultoi fakti nuk përmbushet asnjëri nga elementet e përcaktuara me rregulloren zgjedhore Nr.12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, për pavlefshmërinë e fletëvotimeve për faktin se fletëvotimi është i vulosur; përmban numrin serik të VV përkatës, është votuar vetëm një subjekt politik dhe është kuptuar qartë qëllimi i votuesit, votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik, në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës. Prandaj duke pas parasysh se nuk plotësohet asnjë nga kushtet për pavlefshmërinë e fletëvotimit të përcaktuara me neni 2 të kësaj rregulle zgjedhore kjo gjykatë erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit është e pabazuar.

Përveç të cekurave kjo gjykatë vlerëson se anulimi i votave nuk mund të mbështetet vetëm mbi pretendime të përgjithshme se kandidatët kanë marrë vota nga votues që nuk i përkasin minoritetit përkatës. Një qasje e tillë bie ndesh me parimet themelore të së drejtës së votës, si vota e lirë, e fshehtë dhe e barabartë. Ligji zgjedhor nuk e kushtëzon vlefshmërinë e votës me



përkatësinë etnike të votuesit, por me faktin që ai është i regjistruar ligjërisht dhe ka ushtruar të drejtën e tij në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Për më tepër, pretendimet e pambështetura me prova konkrete nuk mund të shërbejnë si bazë për një masë kaq ekstreme sa anulimi i votave, pasi kjo do të cenonte sigurinë juridike dhe besimin e qytetarëve në procesin zgjedhor. Pranimi i një standardi të tillë do të krijonte një precedent të rrezikshëm, ku rezultati zgjedhor mund të vihet në dyshim thjesht mbi perceptime apo supozime subjektive.

Anulimi i votave në këto rrethana do të rrezikonte gjithashtu përfaqësimin e vetë minoriteteve, pasi do të kufizonte lirinë e tyre për të marrë mbështetje më të gjerë qytetare dhe do t'i izolonte ato politikisht. Përfaqësimi efektiv i minoriteteve nuk arrihet duke përjashtuar vota të ligjshme, por duke garantuar një proces gjithëpërfshirës, të drejtë dhe jo-diskriminues, ku çdo votë e vlefshme ka peshë të barabartë.

Në këtë kuptim, vetëm shkeljet e provuara qartë dhe që kanë ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin zgjedhor mund të justifikojnë ndërhyrje në rezultatin e votimit, ndërsa thjesht fakti se votuesit i përkasin ose jo një minoriteti të caktuar nuk përbën, në vetvete, bazë ligjore për anulimin e votave.

Andaj anulimi i votave vetëm mbi bazën e pretendimeve se kandidatët e një minoriteti kanë marrë mbështetje edhe nga votues që nuk i përkasin atij minoriteti përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve kushtetuese që garantojnë të drejtën e votës dhe barazinë para ligjit. Kushtetuta garanton të drejtën e çdo shtetasi për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, pa asnjë diskriminim, si dhe parimin e votës së lirë, të barabartë dhe të fshehtë. Çdo përpjekje për të vënë në dyshim vlefshmërinë e votës bazuar në përkatësinë etnike të votuesit cenon thelbin e këtyre garancive dhe krijon trajtim të pabarabartë ndërmjet qytetarëve.

Gjithashtu, Kushtetuta ndalon çdo formë diskriminimi mbi baza etnike apo komunitare. Kushtëzimi i efektit juridik të votës me identitetin e votuesit do të thotë vendosje e kriterëve që ligji nuk i njeh dhe që bien ndesh me parimin e proporcionalitetit, pasi masa e anulimit të votave është e pajustifikuar dhe joproporcionale në raport me pretendime të paprovuara.

Gjithashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare, standardet e vendosura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, veçanërisht Protokollin nr. 1, neni 3, kërkojnë që zgjedhjet të zhvillohen në kushte që garantojnë shprehjen e lirë të opinionit të popullit. Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se çdo kufizim i së drejtës së votës duhet të jetë i parashikuar me ligj, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të jetë proporcional. Anulimi i votave mbi baza etnike nuk përmbush asnjë nga këto kritere.

Po ashtu, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike garanton të drejtën e çdo qytetari për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike dhe për të votuar pa dallim. Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka theksuar se masat që kufizojnë pjesëmarrjen politike të grupeve të caktuara duhet të interpretohen ngushtë dhe të justifikohen me arsye objektive dhe të verifikueshme.

Prandaj në vend që të forcojë përfaqësimin e minoriteteve, një praktikë e tillë do të kishte efekt të kundërt do të stigmatizonte kandidatët e minoriteteve, do të kufizonte mbështetjen e tyre demokratike dhe do të minonte integritetin politik dhe shoqëror. Përfaqësimi real i minoriteteve,



sipas standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, synon pjesëmarrje të barabartë dhe efektive në jetën politike, jo izolim elektoral apo trajtim të veçantë diskriminues.

Si rezultat i kësaj, vetëm shkeljet e provuara, konkrete dhe të rënda që cenojnë integritetin e procesit zgjedhor mund të justifikojnë ndërhyrje në rezultatin e votimit. Pretendimet mbi përkatësinë etnike të votuesve, në mungesë të një ndalimi ligjor dhe të provave të qarta, nuk përbëjnë bazë kushtetuese apo ndërkombëtare për anulimin e votave.

Në raport me pretendimet e ankuesit se PZAP, nuk i ka trajtuar fare çështjen në aspektin e shkeljeve kushtetuese nga neni 58 dhe 64, Gjykata Supreme e Kosovës, këtë pretendim e refuzon si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se kjo qasje nuk bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtën e çdo shtetasi për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Përkundrazi, anulimi i votave mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesve do të përbënte vetë një shkelje të këtij neni, pasi do të kufizonte në mënyrë të pajustificuar ushtrimin e së drejtës së votës nga qytetarë që e kanë ushtruar atë në mënyrë të ligjshme. Neni 45 nuk parashikon asnjë kufizim që e lidh vlefshmërinë e votës me identitetin etnik të votuesit, prandaj çdo interpretim i tillë do të ishte zgjerues dhe në kundërshtim me frymën e tij.

Gjithashtu, kjo qasje është në përputhje me nenin 58 të Kushtetutës, i cili garanton mbrojtjen e minoriteteve kombëtare dhe të drejtën e tyre për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar identitetin e tyre. Ky nen synon sigurimin e kushteve që minoritetet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në jetën publike dhe politike, jo izolimin e tyre nga mbështetja më e gjerë qytetare. Marrja e votave edhe nga votues që nuk i përkasin minoritetit nuk cenon identitetin apo të drejtat e minoritetit, por dëshmon integritet dhe pjesëmarrje efektive, në përputhje me qëllimin e këtij neni.

Po ashtu, vendimi i PZAP-së, nuk bie ndesh me nenin 64 të Kushtetutës, i cili rregullon përbërjen e Kuvendit dhe parashikon mekanizma për garantimin e përfaqësimit të minoriteteve. Qëllimi i këtij neni është të sigurojë përfaqësim minimal dhe efektiv të minoriteteve në Kuvend, jo të kufizojë lirinë e votës së qytetarëve apo të imponojë një "elektorat etnik të mbyllur". Përfaqësimi i garantuar sipas nenit 64 nuk përjashton dhe as ndalon që kandidatët e minoriteteve të marrin mbështetje edhe nga votues të tjerë, përkundrazi, ai bashkëjeton me parimin e zgjedhjeve të lira dhe konkurruese.

Në këtë kuptim, interpretimi sipas të cilit votat duhet të anulohen sepse janë dhënë nga votues që nuk i përkasin minoritetit do të ishte në kundërshtim me nenet 45, 58 dhe 64 të Kushtetutës. Këto dispozita, të lexuara së bashku dhe në harmoni me parimet kushtetuese të barazisë, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, mbështesin vlefshmërinë e çdo vote të ligjshme dhe synojnë përfaqësim gjithëpërfshirës, jo përjashtues.

Andaj nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragraf 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.8/2026, datë 09.02.2026.



Kryetari i kolegjit,
Nenad Lazic

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVO/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

SEKRETARATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-8/2026

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LIČNO DOSTAVLJANJE

JEP

Prishti

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ka është dërguar në bashkë dorëzimi i sa pas lëvizjes së lartshkrimit me shkrimin që për shkak të dorëzimit të gjendjet në kohën e caktuar në barmës apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë; anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërkësës, fjalë, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zalecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavještenja da radi dostavljanja bude u određenom vremenu u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odaslom članu domaćina. Primilac naslojila zgrade susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primilacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në barmës në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në detyrë e barmës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom, mestu primilaca (priloženo na vrhuna stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVITETI 09.02.2026

Numri i shiftojave: _____
broj priloga _____

Vërtetohet se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrđeno prijem gorenavogonog pisma
(i slovima)

Prishti 09.02.2026

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primilca ili lica koje je
pismeno primilo u znanju)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkakun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.